

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

Nis funksionimi i plotë i Qendrës së Studimeve për Arbëreshët



Pavarësisht kushteve të vështira të emergjencës, ka vijuar puna pa ndërprerje për vënien në funksion të plotë të kësaj qendre kërkimore-shkencore. Krijimi i Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) synon studimin dhe mbrojtjen e kësaj trashëgimie, përmes koordinimit të lidhjeve më të forta me këtë komunitet për të ruajtur nga asimilimi gjuhën dhe kulturën e arbëreshëve dhe për të promovuar arritjet kryesore të tyre. Kjo qendër është krijuar në kuadër të strukturës shtetërore për diasporën shqiptare dhe do të jetë nën drejtimin e prof. Dr. Diana Kastrioti. Studiues të fushave të historisë, gjuhësisë, letërsisë, antropologjisë etj., do të kryejnë kërkime shkencore dhe do të merren me organizimin e aktiviteteve të cilat do të kenë si fokus komunitetin arbëresh.

Miratohe nga Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën projektet e reja të Qendrës së Botimeve për Diasporën



Qendra e Botimeve për Diasporën e drejtuar nga Mimoza Hysa organizoi mbledhjen online të Këshillit Koordinues të Botimeve të QBD-së. Këshilli, me kryetar drejtorin e Bibliotekës Kombëtare z. Piro Misha, me anëtarë prof. Floresha Dado, përfaqësuese e Akademisë së Shkencave, znj. Mira Hoxha, përfaqësuese e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, znj. Anila Ferizaj, përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe znj. Etleva Kondi, përfaqësuese e Ministrisë së Shtetit për Diasporën, miratoi realizimin e dy projekteve të rëndësishme në ndihmesë të shqiptarëve të diasporës:

- Krijimin e platformës digjitale për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë;
- Botimin e revistës letrare "Letra nga diaspora".

Vazhdon riatdhësimi i shqiptarëve nga vendet e Evropës




Plani i riatdhësimin të qytetarëve shqiptarë të mbetur jashtë kufijve vazhdon edhe me vendet e tjera të Evropës. Gjatë javës së ardhshme harta e kthimit do të përfshijë edhe Spanjën, Rumaninë dhe Austrinë, ndërkohë që vazhdon riatdhësimi nga Franca dhe Mbretëria e Bashkuar. Të gjithë personave që duan të kthehen në Shqipëri i është bërë thirrje që të konsultohen me shërbimet diplomatike në vendet ku ata jetojnë dhe gjithashtu të ndjekin hapat e vëna në dispozicion nga kompania Air Albania.

KKD / Lazim Destani: Bizneset në Diasporë të ndihmojnë vendlindjen

Lazim Destani, anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës si dhe President Nderi i Dhomë së Biznesit të Diasporës Shqiptare, u bën thirrje bizneseve shqiptare në Diasporë që të bashkohen për t'i ardhur në ndihmë vendlindjes së tyre në këtë situatë të vështirë të shkaktuar nga virusi Covid-19.




KKD / Visar Tasimi: Shqipëria ka marrë masat e duhura



Visar Tasimi, anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës në SHBA, flet për origjinën e tij shqiptare, karrierën profesionale dhe angazhimin e tij me Diasporën shqiptare. Gjithashtu, tregon se si po e përjeton situatën e krijuar nga pandemia COVID-19.

Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

Aplikacioni gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

Hapat për procesin e riatdhësimin të qytetarëve shqiptarë

Hapat që duhet të ndjekin qytetarët e interesuar për riatdhësimin nga vendet e BE

- 1 Hyr në faqen e **Air Albania** www.airalbania.com.al në rubrikën **RIATDHËSIM**
- 2 **Prento Hotelin** e karantinimit dhe bëj pagesën online sipas formularit që do të paraqitet **7 Euro/ditë**
- 3 Me kodin e hotelit, që do t'ju vijë në email kthehu në faqen e **Air Albania** dhe **prento biletën**
- 4 Me konfirmimet e hotelit dhe biletës, paraqituni në aeroport në datën, që do t'ju njoftohet nga **Air Albania**
- 5 Me mbërritjen në **Shqipëri** do të shoqërohemi në hotelin e rezervuar, ku do të karantinoheni për **14 ditë**
- 6 Për çdo paqartësi apo informacion të mëtejshëm drejtoheni në numrat **+355 4 224 60 00**, **+355 69 80 47 619**, **+355 69 80 47 633**, **+355 69 80 47 625**